

Deklarata e Rrjetit Evropian të institucioneve kombëtare për të drejtat e njeriut (ENNHRI) mbi rolin e Institucioneve kombëtare të të drejtave të njeriut (NHRI) në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut të personave të zhvendosur brenda vendit gjatë (pas) konfliktit

Riafirmon

- Deklaratën universale mbi të drejtat e njeriut, që shënon 70 vjetorin e saj, si dhe të gjitha standardet ndërkombëtare dhe regjionale mbi të drejtat e njeriut; duke rikujtuar se të drejtat e njeriut janë universale, të pandashme, janë të ndërlidhura dhe plotësohen në mënyrë reciproke.
- Parimet udhëzuese të KB mbi zhvendosjen brenda vendit, që shënojnë përvjetorin e tyre të 20-të.
- Parimet e Parisit lidhur me Statusin e institucioneve kombëtare (A / RES / 48/134), që shënojnë përvjetorin e tyre të 25, sigurojnë njohjen e pavarësisë, pluralizmit, efikasitetit dhe llogaridhënies së Parimeve të Parisit – në pajtim me Institucionet Kombëtare të të drejtave të njeriut;

Rikujton

- Deklaratën e Kievit të vitit 2015 mbi rolin e Institucioneve Kombëtare të të drejtave të njeriut në situatat e konfliktit dhe të pas konfliktit si dhe mundësitë, përgjegjësitë, sfidat dhe kufizimet në kontekste të tilla;
- Deklaratën e Meridës të vitit 2015 mbi rolin e Institucioneve Kombëtare të të drejtave të njeriut në zbatim të Agjendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe në veçanti Objektivin e 16-të të Zhvillimit të Qëndrueshëm në promovimin e shoqërive gjithëpërfshirëse dhe paqësore, sigurimin e qasje në drejtësi për të gjithë dhe ndërtimin e institucioneve efikase, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet;
- Deklaratën e Amanit të vitit 2012 dhe Programin e Veprimit dhe Rolin e Institucioneve Kombëtare të të drejtave të njeriut në promovimin dhe mbrojtja e të Drejtave të Grave dhe Vajzave dhe Barazisë Gjinore; dhe njohjen e ndikimit të veçantë të konfliktit në të drejtat e grave dhe vajzave, përfshirë dhunën në bazë gjinore;

Njeh

- Shkeljet e shumëfishta të të drejtave civile, politike, ekonomike, sociale dhe kulturore të të zhvendosurve brenda territorit të vendit duke përfshirë edhe diskriminimin dhe sfidat me të cilat përballen në qasjen dhe zbatimin e drejtave të tyre si rezultat i zhvendosjes; dhe rëndësinë e pjesëmarrjes së të zhvendosurve brenda vendit në të gjithë vendimet që i prekin ato në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar, duke përfshirë punën në drejtim të zgjidhjeve efikase dhe të qëndrueshme.
- Rolin kyç të Institucioneve Kombëtare të të drejtave të njeriut të promovojnë dhe mbrojnë, në juridiksionin e tyre, të gjitha të drejtat e njeriut, duke përfshirë edhe të drejtat e personave të zhvendosur brenda vendit, duke përdorur edhe mandatet shtesë për të mbështetur këtë rol; dhe se funksionet e tyre janë të shumëllojshme dhe fuqizohen në mënyrë reciproke dhe në këtë mënyrë mund të kenë efekt të shumëfishtë në përkrahje të promovimit dhe të mbrojtjes së të drejtave të njeriut të personave të zhvendosur brenda vendit (PZHBV);
- Rolin e Institucioneve Kombëtare të të drejtave të njeriut si bashkëbisedues midis akterëve të ndryshëm dhe rolin e tyre përafrues midis arenave kombëtare dhe ndërkombëtare, në mes të shtetit dhe shoqërisë civile; dhe rolin e tyre në lehtësim të koordinimit në mes të akterëve, përfshirë këtu edhe ndërmjetësimin, kur është i duhur.

Institucionet Kombëtare të të drejtave të njeriut të Evropës (ENNHRI) theksojnë se roli i tyre përfshijnë:

Këshillimin e qeverive, parlamenteve dhe autoriteteve tjera shtetërore mbi të drejtat e njeriut

- Avokim mbi ratifikimin dhe promovimin e instrumenteve ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut dhe inkorporimi i tyre në ligjet kombëtare, përfshirë Parimet udhëzuese të KB mbi zhvendosjen e brendshme si dhe zbatimin efikas i tyre në nivel kombëtar.
- Avokim kundër derogimeve disproporcionale të standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut si dhe masat emergjente të miratuara në nivel kombëtar, të cilat duhet të kufizohen në kohë dhe hapësirë;
- Ofrimi i ekspertizës dhe rekomandimeve mbi përmbajtjen dhe zbatimin e legjislacionit dhe të politikave strategjike të PZHBV, përfshirë këtu qasjen e bazuar në të drejtat e njeriut dhe sigurimin e rishikimit të rregullt dhe vazhdimësinë e këtyre rekomandimeve;

Monitorimi i të drejtave të njeriut të PZHBV

- Monitorimi i kornizave ligjore, administrative dhe të politikave me ndikim në të drejtat e personave të PZHBV;

- Identifikimi i fakteve dhe grumbullimi i të dhënave për situatën e personave të zhvendosurve brenda vendit me theks të veçantë në persona të cilët janë veçanërisht të lëndueshëm në kontekstin e (pas) konfliktit, duke përfshirë: gratë dhe vajzat; fëmijët; të moshuarit; personat me aftësi të kufizuara; personat me përkatësi të ndryshme etnike, gjuhësore, fetare dhe minoritetet si dhe personat me përcaktim LGBTI;
- Monitorimi i objekteve të strehimit, qendrave kolektive dhe vendeve ku PZHBV mund të jenë të privuar nga liria (përfshirë objektet publike dhe private), si dhe qasjen dhe gëzimin e të drejtave të tyre pronësore;
- Vëzhgimi i zgjedhjeve dhe monitorimi i qasjes së personave të zhvendosur në të drejtat e tyre aktive dhe pasive zgjedhore si dhe pjesëmarrjen e tyre publike në të gjitha nivelet;
- Monitorimi i qasjes së PZHBV në gëzimin e të gjitha të drejtave tjera civile, politike, ekonomike, sociale dhe kulturore, në barazi të plotë me personat tjerë në atë shtet;
- Ndërmarrja e masave urgjente, kur është e nevojshme, në bazë të të gjeturave dhe aktiviteteve të tyre monitoruese.

Raportimi mbi gjendjen e PZHBV tek autoritetet kombëtare, regjionale dhe ndërkombëtare:

- Raportimi tek autoritetet kombëtare mbi gjendjen e të drejtave të njeriut të PZHBV, përfshirë këtu rekomandimet dhe raportet dërguar Parlamenteve dhe autoriteteve tjera shtetërore, si dhe ndërmarrja e veprimeve relevante në vazhdimësi;
- Raportimi tek mekanizmat regjional dhe ndërkombëtar mbi të drejtat e njeriut si dhe bartësve relevant të mandateve mbi zbatimin e standardeve kombëtare të të drejtave të njeriut si dhe të Parimeve udhëzuese të KB mbi zhvendosjen brenda vendit si dhe ndërmarrjen e veprimeve të duhura në vazhdimësi për sa i përket komunikimit, rekomandimeve dhe mendimeve të cilat burojnë nga këto mekanizma;
- Raportimi në opinion të gjerë mbi gjendjen e të drejtave të njeriut të personave të zhvendosur brenda vendit, përfshirë edhe njoftimin përmes mediave.

Kur brenda mandatit të Institucioneve Kombëtare të të drejtave të njeriut duhet ofruar asistencë ligjore dhe të veprohet lidhur me ankesat:

- Ofrimi i asistencës ligjore personave të zhvendosur brenda vendit mbi të drejtat e tyre dhe lehtësimi i qasjes së tyre në drejtësi, mjete juridike dhe reparacion;
- Lidhur me ankesat mbi të drejtat e njeriut të PZHBV, të veprohet në përputhje me standardet regjionale dhe ndërkombëtare si dhe me Parimet udhëzuese të KB mbi zhvendosjen brenda vendit;
- Inicimi i procedurave gjyqësore, parashtrimi i amicus curiae, përfshirja dhe mbështetja e proceseve gjyqësore strategjike dhe adresimi në Gjykatën Kushtetuese, por edhe në çdo gjykatë tjetër kompetente ose organe tjera që merren me shqyrtimin e ankesave në nivel kombëtar dhe ndërkombëtarë, me qëllim të lehtësimit të përmbushjes së të drejtave të njeriut të PZHBV.

Promovimi dhe avancimi i njohurive mbi të drejtat e njeriut dhe ngritja e vetëdijes së publikut të gjerë:

- Informimi i PZHBV mbi të drejtat e tyre dhe lehtësimi i qasjes së tyre në informata, përfshirë këtu përkrahjen multi-disiplinare dhe psikologjike;
- Ngritja e vetëdijes së publikut të gjerë mbi të drejtat e njeriut të personave të zhvendosur brenda vendit dhe situatën e tyre në kontekstin kombëtar.
- Promovimi, përfshirja dhe ndërmarrja e aktiviteteve trajnuese mbi të drejtat e njeriut të PZHBV për të gjithë akterët relevant kombëtar, përfshirë shërbyesit civil, profesionistët e zbatimit të ligjit, gjyqësorin si dhe profesionistët tjerë ligjor; shoqërinë civile, mbrojtësit e të drejtave të njeriut, gazetarët dhe publikun e gjerë në përgjithësi.

Bashkëpunimi me akterët relevant

- Bashkëpunimi me autoritetet shtetërore kombëtare dhe lokale, PZHBV dhe komunitetet vendore, shoqërinë civile dhe mbrojtësit e të drejtave të njeriut;
- Bashkëpunimi me akterët regjional dhe ndërkombëtar, përfshirë organizatat ndërkombëtare dhe Institucionet Kombëtare të të drejtave të njeriut në juridiksionet tjera, përmes rrjeteve të Institucioneve Kombëtare të të drejtave të njeriut si Rrjetit Evropian të institucioneve kombëtare për të drejtat e njeriut (ENNHRI) dhe Aleancës Botërore për Institucionet Kombëtare për të Drejtat e Njeriut- GANHRI;
- Zhvillimi i aktiviteteve të përbashkëta që kanë për synim promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut të PZHBV;
- Bashkëpunimi me shoqërinë civile, organizatat ndërkombëtare dhe /ose Institucionet Kombëtare të të drejtave të njeriut në juridiksione tjera kur një veprim i tillë është i dobishëm për të lehtësuar qasjen në territor jashtë kontrollit të shtetit.

Kjo deklaratë fillimisht është konceptuar nga anëtarët e Rrjetit Evropian të institucioneve kombëtare për të drejtat e njeriut (ENNHRI) të cilët punojnë në të drejtat e njeriut të PZHBV dhe pjesëmarrësve të takimit të ENNHRI në Kiev, Ukrainë, mbi rolin e Institucioneve kombëtare për të drejtat e njeriut (NHRI) në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut të PZHBV gjatë (pas) konfliktit (prill 2018). Këto konstatime do të kontribuojnë në zbatimin efikas të Planit të Veprimit shumë palësh për Avancim të parandalimit, mbrojtjes dhe zgjidhjeve për personat e zhvendosur brenda vendit 2018-2020, të lansuar me rastin e 20 vjetorit të Parimeve Udhëzuese të KB mbi zhvendosjen brenda vendit.

Maj 2018